



Bashkia Korçë
Koha për Korçën

PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026–2028



Plani Arsimit Parauniversitar 2026 - 2028

Përmbajtja

1. Hyrje dhe konteksti.....	6
Konteksti administrativ	6
Të dhëna demografike.....	6
Analiza demografike dhe implikimet për planifikimin arsimor.....	9
1. Qendra urbane: Njësia Administrative Korçë	9
2. Njësi me potencial zhvillimi të integruar	9
3. Njësi të përziera me vështirësi në akses por me prani të qëndrueshme.....	9
4. Njësi me popullsi të ulët dhe fragmentuar.....	9
Rekomandime për zbatim.....	9
Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor.....	10
2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025.....	11
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor.....	11
Frekuentimi në kopshte	12
3. Analiza e shërbimit në shkollat e arsimit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025	13
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit.....	13
Frekuentimi në arsimin fillor.....	14
Frekuentimi arsimi 9-vjecar	14
Frekuentimi arsimi i mesëm.....	14
4. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative	15
Njësia Administrative: Korçë.....	15
Njësia Administrative: Qendër Korçë (Bulgarec).....	16
Njësia Administrative: Voskop	18
Njësia Administrative: Voskopojë	19
Njësia Administrative: Lekas	19
Njësia Administrative: Vithkuq	19
Njësia Administrative: Mollaj	20
Njësia Administrative: Drenovë.....	21
5. Analiza dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve në Shkollat e Bashkisë Korçë	22
Metodologjia e prioritarizimit	23
Analiza e prioritarizimi i ndërhyrjeve në shkollat e Qytetit të Korçës.....	24
Analiza e prioritarizimi i ndërhyrjeve në shkollat e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë..	25
6. Analiza dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve në kopshtet e Bashkisë Korçë	27
7. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar	30

Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve	30
8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar	33
Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar	33
9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	35
10. Plani i investimeve kapitale	59
11. Monitorimi dhe vlerësimi	60
Indikatorët e Performancës.....	60
Planifikimi i vlerësimit të progresit.....	60
Përfshirja e aktorëve të jashtëm	60
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi.....	60
Monitorimi i realizimit të aktiviteteve	60
Vlerësimi i ndikimit në komunitet	61
12. Rishikimi dhe përshtatja e planit.....	61
Procesi i rishikimit	61
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve.....	62
13. Raportimi dhe transparenca	62
14. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar	63

Parathënie

Në themel të një qyteti që zhvillohet me dinjitet dhe vizion qëndron cilësia e arsimit që u ofron brezave të rinj. Ne, si Bashki Korçë, e shohim arsimin parauniversitar jo vetëm si një e drejtë themelore për çdo fëmijë, por edhe si një instrument të fuqishëm për barazi sociale, zhvillim të qëndrueshëm dhe forcim të identitetit qytetar.

Hartimi i Planit të Arsimit Parauniversitar 2025–2030 përfaqëson një nga angazhimet tona më të rëndësishme për të garantuar se asnjë fëmijë nuk mbetet pas dhe se çdo institucion edukativ është një hapësirë që frymëzon, fuqizon dhe kujdeset. Ky plan është ndërtuar mbi një vizion të përbashkët dhe të guximshëm:

"Të garantojmë akses të barabartë, cilësi të lartë dhe përfshirje të plotë në arsimin parauniversitar për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Korçë – duke përmirësuar e modernizuar shërbimin në shkolla dhe kopshte si qendra komunitare që formësojnë qytetarë të denjë, të ditur dhe socialisht të ndërgjegjshëm"

Në përputhje me këtë vizion, plani përfshin objektiva të qarta dhe ndërhyrje të shumëanshme që synojnë përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës shkollore dhe kopshteve, forcimin e kapaciteteve të stafit edukativ, përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe përkujdesjes, si dhe promovimin e një kulture gjithëpërfshirjeje dhe pjesëmarrjeje sociale.

Vetëm për periudhën 2026–2028 përmes këtij plani angazhohemi duke parashikuar mbi 139 milionë lekë në investime kapitale për rikonstruksionin dhe pajisjen e institucioneve arsimore në të gjitha nivelet. Këto investime janë të orientuara drejt një standardi bashkëkohor që garanton siguri, funksionalitet dhe mjedise stimuluese për të nxënëit dhe zhvillimin e fëmijëve.

Por ky plan nuk është thjesht një listë investimesh. Ai është një reflektim i vlerave që na bashkojnë si komunitet: përkushtimi për barazi dhe drejtësi sociale, respekti për fëmijërinë, dhe besimi se shkolla është zemra e lagjes dhe bërthama e zhvillimit të qëndrueshëm. Për këtë arsye, kemi vënë në qendër të planit edhe përfshirjen aktive të komunitetit, bashkëpunimin me prindërit, institucionet kulturore dhe sportive të qytetit, si dhe zhvillimin e aktiviteteve që nxisin identitetin, bashkëpunimin dhe frymën qytetare.

Ky dokument është rezultat i një procesi të gjerë reflektimi dhe bashkëpunimi me drejtues institucionesh, edukatorë, përfaqësues të prindërve dhe partnerë të rëndësishëm zhvillimi. Ai është një plan i gjallë, që do të përshtatet në kohë, në funksion të nevojave që lindin dhe mundësive që krijohen.

Ne e marrim këtë angazhim me seriozitetin më të madh, duke e konsideruar investimin në arsim si investimin më të mençur dhe më jetëgjatë që mund të bëjmë për qytetin tonë.

Korça ka qenë gjithmonë vatër e dijes dhe përparimit – dhe me këtë plan, synojmë të rikonfirmojmë këtë rol me përkushtim, përpulësi dhe vizion.

Sotiraq Filo

Kryetar i Bashkisë Korçë

Falënderime

Bashkia Korçë shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Korçës, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioriteteve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Korçë.

1. Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Korçë përfshin një numër njësish administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Kjo strukturë e përbërë nga 8 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukture dhe financiare.

Prania e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.

Aktualisht, Bashkia Korçë përfshin gjithsej 8 njësi administrative:


- Korçë
- Qendër Korçë (Bulgarec)
- Voskop
- Voskopojë
- Lekas
- Vithkuq
- Mollaj
- Drenovë

të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Të dhëna administrative	Vlerë
Sipërfaqja	805.99 km ²
Popullsia bashkisë	54,279 (Cens 2023)
Popullsia qyteti Korçë	43254 (Cens 2023)0
Njësi administrative	8: Korçë, Qendër Korçë, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj, Drenovë
Fshatra të përfshira	62 fshatra përmes njësive

Të dhëna demografike


Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Korçë është 54,279 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 26,973 meshkuj dhe 27,306 femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori.



Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm.

Emri i Njesise Administrative	Gjinia	Numri i banorëve sipas gjinisë
Korçë	Femer	22154
	Mashkull	21100
Qëndër Korçë (Bulgarec)	Femer	3159
	Mashkull	3316
Voskop	Femer	1060
	Mashkull	1219
Voskopojë	Femer	239
	Mashkull	272
Lekas	Femer	86
	Mashkull	115
Vithkuq	Femer	456
	Mashkull	462
Mollaj	Femer	1281
	Mashkull	1334
Drenovë	Femer	2030
	Mashkull	2471

Grupmosha	Numri i banoreve
0-4 vjeç	2306
5-9 vjeç	2695
10-14 vjeç	2929
15-19 vjeç	3002



Përshkrim demografik sipas njësive administrative në Bashkinë Korçë:

Në kuadër të planifikimit të shërbimeve arsimore parauniversitare, është me rëndësi të kuptohet struktura demografike e popullsisë në territorin e Bashkisë Korçë. Kjo bashki përfshin një përzierje të zonave urbane dhe rurale, ku dinamika e popullsisë ndryshon në varësi të pozicionit gjeografik, infrastrukturës dhe aksesit ndaj shërbimeve publike.

- **Njësia administrative Korçë**, që përfshin qendrën urbane të qytetit, ka një popullsi prej 43,254 banorësh, me 22,154 femra dhe 21,100 meshkuj. Kjo përfaqëson bërthamën më të madhe demografike të bashkisë dhe ofron infrastrukturën më të zhvilluar arsimore dhe shëndetësore.
- Në njësinë administrative **Voskop**, jetojnë gjithsej 2,279 banorë, nga të cilët 1,060 janë femra dhe 1,219 janë meshkuj. Popullsia është e shpërndarë në disa fshatra të vogla, me nevoja të veçanta për akses në shërbime të hershme edukimi.
- **Voskopoja**, një njësi me karakter historik dhe potencial turistik, numëron gjithsej 511 banorë, prej të cilëve 239 janë femra dhe 272 meshkuj. Për shkak të sipërfaqes së madhe dhe numrit të ulët të banorëve, shërbimet publike janë më të fragmentuara.
- Në njësinë **Lekas** jetojnë vetëm 201 banorë (86 femra dhe 115 meshkuj), duke e bërë atë një nga zonat më pak të populluara të bashkisë. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe eficiencën e ofrimit të shërbimeve edukative dhe sociale.
- **Vithkuqi** ka një popullsi prej 918 banorësh, me një shpërndarje relativisht të balancuar gjinore: 456 femra dhe 462 meshkuj. Kjo njësi ndodhet në një zonë të thellë malore dhe ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e shërbimeve të integruara për fëmijët e moshës parashkollore.
- **Mollaj** përfshin 2,615 banorë, nga të cilët 1,281 janë femra dhe 1,334 meshkuj. Popullsia është më e përqendruar dhe ndërlidhet më ngushtë me zonën urbane, çka krijon potencial për zgjerim dhe përmirësim të rrjetit të kopshteve dhe çerdheve.
- **Drenova** ka një popullsi prej 4,501 banorësh (2,030 femra dhe 2,471 meshkuj). Për shkak të pozicionit gjeografik dhe zhvillimit më të mirë ekonomik, kjo njësi paraqet kushte më të

favorshme për zgjerimin e rrjetit edukativ dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme të fëmijëve në sistemin parashkollor.

Analiza demografike dhe implikimet për planifikimin arsimor

Në Bashkinë Korçë vihet re një ndarje e qartë ndërmjet **njësive urbane dhe rurale**, ku dinamika e popullsisë ndikon ndjeshëm në mënyrën sesi duhet strukturuar dhe investuar në shërbime arsimore, veçanërisht për grupmoshën 0–6 vjeç.

1. Qendra urbane: Njësia Administrative Korçë

- **43,254 banorë** (bërthama kryesore)
- Ofron infrastrukturën ekzistuese më të mirë për kopshte dhe çerdhe.
- **Potencial:** Përmirësim i rrjetit për të përballuar rritjen e mundshme të përfshirjes dhe për të mbuluar nevojat e lagjeve periferike.
- **Qasje:** modernizim, riorganizim hapësinor dhe përmirësim i standardeve në kopshtet ekzistuese.

2. Njësi me potencial zhvillimi të integruar

- **Drenovë (4,501 banorë)** dhe **Mollaj (2,615 banorë)** paraqesin përqendrim të qëndrueshme popullore, shpërndarje të mirë gjinore dhe afërsi me qytetin.
- **Potencial:** Përmirësim i shërbimit të kopshteve në zona me dendësi banimi ose me mungesë të theksuar infrastrukture edukative.
- **Qasje:** Mund të investohet në kopshte multifunktionale që shërbejnë edhe si qendra komunitare.

3. Njësi të përziera me vështirësi në akses por me prani të qëndrueshme

- **Voskop (2,279 banorë)** dhe **Vithkuq (918 banorë)** kanë shpërndarje në fshatra të vegjël dhe pozicion gjeografik të thelluar.
- **Potencial:** Investime në njësi që shërbejnë si qendra graviteti për disa fshatra, si dhe mbështetje me transport apo shërbime të lëvizshme.
- **Qasje:** Modele të decentralizuara të ofrimit të shërbimit dhe investim në funksione mbështetëse (si qendrat multifunktionale).

4. Njësi me popullsi të ulët dhe fragmentuar

- **Voskopja (511 banorë)** dhe **Lekas (201 banorë)** kanë densitet shumë të ulët dhe sfida të larta gjeografike.
- **Potencial i kufizuar për struktura klasike** për shkak të raportit të pafavorshëm kosto/përfitim.
- **Qasje:** modele alternative si bashkëpunime ndërmjet-njësive administrative, mbështetje me transport.

Rekomandime për zbatim

1. Të përdoret një **model trevjeçar** me një kombinim ndërhyrjesh kapitale (ndërtim/rikonstruktion), funksionale (trajnime/logjistikë), dhe sociale (ndërgjegjësim komunitar, transport).

2. Të sigurohet **monitorim vjetor i lëvizjes së popullsisë** në zonat rurale për të përditësuar planifikimin.
3. Të inkurajohen **modele fleksibël shërbimi** për zonat me popullsi të ulët: qendra të përbashkëta, mikroshërbime, qendra multifunksionale.

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Korçë në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim.

Bazën më të lartë ligjore e përbën **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes **Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”**, të ndryshuar me **Ligjin nr. 48/2018**, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe koordinimit me institucionet qendrore. Këto funksione financohen dhe mbështeten në përputhje me **Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, dhe **Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”**, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Po ashtu, **Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”**, i ndryshuar, shërben si mjet për mobilizimin e të ardhurave që bashkia mund të përdorë për të mbështetur sektorin e arsimit.

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet është **Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020**, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe **Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023**, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit. Po ashtu, **udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, specifikon organizimin e vitit shkollor 2024–2025, ndërsa **Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018**, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi. Një dokument me rëndësi për cilësinë e arsimit parashkollor është edhe **Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024**, që miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Korçë udhëhiqet gjithashtu nga **Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”** dhe **Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**, të cilët kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social. Në këtë drejtim, udhëzime specifike si **Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014**, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe **Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025**, përbëjnë udhërrëfyes për politikat lokale në territorin e Bashkisë Korçë.

Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i **shërbimit psiko-social në shkolla**, i cili rregullohet me **Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020**, si dhe me **udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor**, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore. Gjithashtu, për të garantuar një ambient të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet **Udhëzimi i**


përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.

Nëpërmjet këtij kuadri të gjerë ligjor dhe politik, Bashkia Korçë vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Zyrën Vendore Arsimore dhe institucionet e tjera publike, synohet ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.

2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor

Në Bashkinë Korçë shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Korçë funksionojnë 49 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.



Njesia Administrative	Numri i Kopshteve
Korçë	19
Qendër Korce	11
Voskop	5
Voskopojë	2
Vithkuq	3
Mollaj	4
Drenovë	5
Lekas	0


Frekuentimi në kopshte

- Në bashkinë Korçë, sipas të dhënave më të fundit, numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 1693, prej të cilët 831 janë djem dhe 862 janë vajza. Nga kjo popullsi, 1122 fëmijë ndjekin institucionet parashkollore (kopshtin), konkretisht 546 djem dhe 576 vajza.
- Kjo përfaqëson një përqindje të përgjithshme prej 66.27% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimimin parashkollor. Megjithatë, 571 fëmijësh ende nuk ndjekin kopshtin nga të cilët 285 janë djem dhe 286 janë vajza, duke treguar një boshllëk të rëndësishëm në përfshirje që kërkon vëmendje institucionale. Për të kuptuar më mirë arsyet e këtij mosfrekuentimi, është e domosdoshme një analizë e thelluar e faktorëve që ndikojnë në këtë fenomen. Një ndër faktorët kryesorë është emigracioni dhe migracioni i brendshëm. Lëvizjet e familjeve, sidomos drejt zonave urbane ose jashtë vendit, kanë ndikuar në uljen e popullsisë fëmijë në shumë zona rurale, duke e bërë joefikase mbajtjen e institucioneve të arsimit parashkollor në funksion. Një tjetër arsye thelbësore është fakti që arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm me ligj, çka ndikon ndjeshëm në zgjedhjen e prindërve për të mos i regjistruar fëmijët në kopshte, sidomos në mjedise me mungesë ndërgjegjësimi apo me kushte të vështira ekonomike.

Bazuar në këtë analizë, lind nevoja për një ndërhyrje të orientuar në të dhëna. Bashkia duhet të ndërmarrë një vlerësim gjeografik dhe demografik për të hartuar një hartë të përfshirjes në territor, e cila do të identifikojë me saktësi zonat që kanë boshllëqe dhe potencial për investim. Po ashtu, është e rëndësishme të ndërtohen mekanizma ndërgjegjësimi për prindërit dhe komunitetet, në mënyrë që të rritet kuptimi mbi rëndësinë e edukimit të hershëm. Kjo mund të shoqërohet edhe me masa praktike si transport falas, vakte për fëmijët, apo mbështetje sociale për familjet në nevojë.

- Të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor tregojnë se në total 66.27% e fëmijëve ndjekin kopshtin. Brenda këtij grupi, përqindja e përfshirjes ndryshon midis gjinive: 65.70% e djemve dhe 66.82% e vajzave janë të përfshirë në edukimin parashkollor. Ky ndryshim, tregon prirje që mund të ndikohen nga faktorë lokalë si infrastruktura, ndërgjegjësimi prindëror apo mundësitë ekonomike.
- Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Korçë.

Grafiku më poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin sipas grupit total, djemve dhe vajzave.



3. Analiza e shërbimit në shkollat e arsimit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025


Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Në territorin e Bashkisë Korçë janë të shpërndara gjithsej 57 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative urbane dhe rurale të bashkisë. Këto institucione përfaqësojnë një rrjet të gjerë dhe të larmishëm të arsimit parauniversitar.

Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore

- ✚ **Shkollat fillore** u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.
- ✚ **Shkollat 9-vjeçare** përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.
- ✚ **Shkollat e mesme** përfshijnë gjimnazet dhe shkollat profesionale, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.



Frekuentimi në arsimin fillor

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	2631	51.88
Vajza	1266	48.12
Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor	2631	

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 2631, nga të cilët 1365 janë djem dhe 1266 vajza. Sipas të dhënave të raportuara, 51.88% e tyre janë djem dhe 48.12% vajza. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdimet të përpjekjeve për të garantuar akses të

barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

Frekuentimi arsimit 9-vjeçar

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 2450 nxënës, prej të cilëve 1258 janë djem dhe 1192 vajza. Sipas të dhënave, 51.35% e nxënësve janë djem dhe 48.65% janë vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë. Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të

pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	1258	51.35
Vajza	1192	48.65
Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor	2450	

Frekuentimi arsimit i mesëm

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 2004 nxënës, nga të cilët 1108 janë djem dhe 896

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	1108	55.29
Vajza	896	44.71
Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor	2004	

vajza, përkatësisht 55.29% djem dhe 44.71% vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe

faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

4. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative


Njësia Administrative: Korçë

Shkollat

Në total, funksionojnë 24 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 3 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 13 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 8 janë shkolla të mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës
Asdreni
Demokracia
Faik Konica
Ismail Qemali
MPShqipe
Naim Frashëri
Naum Vehqilarxhi
Nuçi Naçi
Raqi Qirinxhi
Sotir Gurra
Speciale
Stavri Themeli
Themistokli Germenji
Ymer Dishnica

Isuf Dalipi
Kolegji i Korçës Omiros
Platon
IEVP
Tefta Tashko Koço
Sevasti Qirjazi
Kolegji Preka
Stavri Toçi
Asim Zagori
Filllore Pulahë

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 19 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:


Emri i kopshtit
Sevasti Qirjazi (g.par.)
Nr 1
Nr 2
Stavri Themeli (g.par.)
Nr 3
Nr 4
Nr 5
Nr 6
Lulet E Vogla
Nr 7
Nr 8
Nr 9
Nr 10
Nr 11
Demokracia (g.par.)
Nr 12
S. Gurra (g.par)
Shkolla E Re(g.par)
Nuci Naci(g.par)

Njësia Administrative: Qendër Korçë (Bulgarec)

Shkollat

Në total, funksionojnë 11 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 3 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 8 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit.

Ndarja e shkollave sipas kategorizimit



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës
Belorta
Bulgarec
Dishnicë
Lumalas
Pandeli Cale
Biranj
Melcan
Shamoll
Çiflig
Neviçisht
Kuç i Zi

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 11 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.


Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Bulgarec
Lumalas
Biranj
Melçan
Dishnicë
Barç
Belorta
Neviçisht
Kuç i Zi
Shamoll
Çiflig

Njësia Administrative: Voskop

Shkollat

Në Njësine administrative Voskop funksionojnë 7 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 2 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 5 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës
Polenë
Vinçan
Voskop
Dersnik
Goskovë
Porodinë
Dersnik

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Voskop
Dërsnik
Vinçan
Goskovë
Porodinë

Njësia Administrative: Voskopojë

Shkollat

Në Voskopojë funksionojnë 3 shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit,

Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
Voskopojë
Gjonomadh
Lavdar

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 2 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Voskopojë
Gjonomadh

Njësia Administrative: Lekas

Shkollat

Në Njësinë administrative Lekas funksionojnë 2 shkolla: 1 shkollë e ciklit fillor, dhe 1 shkollë 9-vjeçare.

Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës
Lekas
Marjan

Kopshtet


Në njësinë administrative Lekas nuk ka kopshte të hapura.

Njësia Administrative: Vithkuq

Shkollat

Në Vithkuq funksionojnë 4 shkolla. Nga këto, 1 shkollë është e ciklit fillor, ndërsa 3 janë shkolla 9-vjeçare.

Ndarja e shkollave sipas kategorizimit



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës
Lubonje
Panarit
Leshnje
Naum Veqilharxhi, Vithkuq

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionojnë gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Vithkuq
Lubonjë
Panarit

Njësia Administrative: Mollaj

Shkollat


Në Njësinë administrative Mollaj funksionojnë 3 shkolla, 2 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 është shkollë e mesme

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.

Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës
Kamenicë
Mollaj
9- vjecare Floq

Ndarja e shkollave sipas kategorizimit



Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 4 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:


Emri i kopshtit
Mollaj
Kamenicë
Pulahë
Floq

Njësia Administrative: Drenovë

Shkollat

Në total, funksionojnë 3 shkolla, 1 shkollë në ciklin fillor, ndërsa 2 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit.

Ndarja e shkollave sipas kategorizimit



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
Mborje
Qatrom
Kiço Grabocka

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësive janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Drenovë
Mborje
Ravonik
Turan
Qatrom

5. Analiza dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve në Shkollat e Bashkisë Korçë

Në funksion të përmirësimit të infrastrukturës arsimore në Bashkinë Korçë dhe në kuadër të Planit të Arsimit Parauniversitar, është realizuar një vlerësim i detajuar mbi gjendjen e shkollave 9-vjeçare në territorin e bashkisë. Vlerësimi përfshin një sërë indikatorësh praktikë dhe teknikë që lidhen me sigurinë, funksionalitetin, cilësinë e ndërtesave, si dhe me përmbajtjen didaktike që mundëson ofrimi i shërbimit edukativ.

Të dhënat përfshijnë:

- Numrin aktual të nxënësve në çdo shkollë;
- Historikun e rikonstruksioneve dhe nevojën për ndërhyrje të reja;
- Problematikat infrastrukturore si: amortizimi i rrjeteve elektrike dhe hidrosanitare, dëmtime strukturore, mungesë e kabineteve apo laboratorëve të specializuar;
- Kërkesa të brendshme për përmirësim të kushteve mjedisore dhe energjetike.

Për të pasur një vlerësim sa më të plotë të kontekstit, është analizuar edhe struktura demografike dhe gjeografike e Bashkisë Korçë. Kjo bashki përfshin një përzierje të zonave urbane me përqendrim të lartë popullsie (si Njësia Korçë), si dhe zona rurale me përhapje të ulët të popullsisë (si Lekasi apo Voskopoja), ku sfidat për ofrim të barabartë të shërbimit arsimor janë më të mëdha.

Qëllimi i analizës është të sigurojë një bazë objektive për vendimmarrjen mbi prioritetet e investimeve publike në shkollat 9-vjeçare, duke garantuar përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë fëmijët në territorin e Bashkisë Korçë, në përputhje me karakteristikat demografike dhe territoriale të njësive përkatëse.

Metodologjia e prioritarizimit

Për të përzgjedhur dhe renditur ndërhyrjet prioritare, janë përdorur dy kritere bazë:

a. Emergjenca e ndërhyrjes (E):

Problematikat janë klasifikuar në emergjente (që lidhen me sigurinë fizike të ndërtesës dhe funksionimin bazë të saj), kritike funksionale (që ndikojnë në cilësinë e të nxënësve), dhe estetike apo mirëmbajtjeje të përgjithshme (pa ndikim të drejtpërdrejtë në siguri).

Vlerësohet niveli i urgjencës në bazë të tipologjisë së problematikës:

- **Emergjente:** problematika që rrezikojnë sigurinë fizike (strukturë, rrjet elektrik, amortizim i rëndë)
- **Kritike funksionale:** mungesë laboratorësh, ambiente të amortizuara por jo të rrezikshme
- **Estetike / të moderuara:** nevoja mirëmbajtjeje, energjetike, dritare, suvatime

b. Numri i përfituesve (P):

- Ky kriter synon të evidentojë shkollat me ndikim më të gjerë social, përmes numrit të nxënësve që frekuentojnë institucionin.

Duke kombinuar këto dy kritere, është ndërtuar një matricë prioritare e cila kategorizon investimet në tri nivele:

Kategoria	Emergjencë	Nxënës (Përfitues)	Prioritet
A – Shumë i lartë	● Po	>300	1
B – i lartë	● Po	>100	2
C – i mesëm/ulët	● / S'ka	≤100	3

Ky vlerësim mundëson një ndarje më të drejtë të burimeve buxhetore dhe orientim të ndërhyrjeve atje ku ndikimi është më i madh dhe nevoja më urgjente.

Analiza e të dhënave dhe renditja prioritare

Bazuar në të dhënat e mbledhura për secilën shkollë, më poshtë paraqitet një përmbledhje e klasifikimit sipas prioritetit të ndërhyrjes. Në renditje është marrë parasysh edhe vendndodhja gjeografike dhe karakteristikat demografike të njësisë administrative ku ndodhet shkolla, për të ndihmuar në vendimmarrjen kontekstuale.

Për shembull, në Njësinë Administrative Korçë, ku përqendrohet mbi 50% e popullsisë së bashkisë dhe ku frekuentimi i shkollave është më i lartë, çdo problematikë në shkolla përkthehet në ndikim të menjëhershëm dhe masiv në cilësinë e shërbimit arsimor. Në këtë zonë janë të vendosura disa nga shkollat me prioritet emergjent, si "Sotir Gurra" me 629 nxënës apo "Ismail Qemali" dhe "Demokracia", të cilat kanë nevojë për rikonstrukcion total dhe përmirësime infrastrukture.

Në njësitë me karakter rural, si Voskopi apo Vithkuqi, shkollat mund të kenë numër më të vogël nxënësish, por në kushtet e fragmentimit të popullsisë dhe distancave të mëdha, këto shkolla përbëjnë pikën e vetme të aksesit në arsim. Prandaj, edhe për shkollat si "Naum Veqilharxhi" apo "Faik

Konica" investimi nuk është vetëm teknik, por ka ndikim në mbajtjen e fëmijëve në sistem dhe parandalimin e braktisjes.

Në shkollat e njësive si Mollaj apo Drenovë, të cilat kanë zhvillim ekonomik më të mirë dhe janë më afër qytetit, problemet janë më pak të theksuara por mund të përmirësohen përmes ndërhyrjeve funksionale dhe modernizuese.

Analiza e prioritarizimi i ndërhyrjeve në shkollat e Qytetit të Korçës

A. Prioritet shumë i lartë (ndërhyrje emergjente)

Nr	Shkolla	Nxënës	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
1	9 – vjeçare “Demokracia”	187	Restaurim total, mungesë kabinetesh	Ndërhyrje emergjente për funksionalitetin bazë		1
2	9 – vjeçare “Naum Veqilharxhi”	134	Restaurim total, mungesë laboratorësh	Ndërhyrje strukturore, lidhur me mësimdhënien moderne		1
3	9 – vjeçare “Ismail Qemali”	151	Restaurim total + rrjet elektrik i amortizuar	Amortizim i dyfishtë: strukturor dhe elektrik		1
4	9 – vjeçare “Sotir Gurra”	629	Rrjet elektrik i amortizuar	Rrezik sigurie – shumë nxënës përfitues		1
5	Gjimnazi “Faik Konica”	130	Lageshtirë + izolim + dritare	Dëmtime të përhapura me ndikim në higjienë dhe funksionim		1

B: Prioritet i lartë

Nr	Shkolla	Nxënës	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
6	Shkolla 9 – vjeçare “Asdreni”	202	Nevojë për kaldajë + dritare	Kushte të papërshtatshme në dimër		2
7	Konvikti i gjuhëve të huaja	38	Rrethim, mobilim, ndriçim, terene	Pavarësisht numrit të ulët – ndikon në siguri dhe jetesë		2

C: Prioritet i mesëm

Nr	Shkolla	Nr. Nxënësve	Problematika	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
8	Gjimnazi “Tefta Tashko Koço” (9v + gjimnaz)	130 (9v) / 38 (gj)	Pastrim ullukësh, suvatura	Ndërhyrje estetike dhe mirëmbajtje – jo emergjente	●	3
9	Gjimnazi “Raqi Qirinxhi”	538	Suva në kat të dytë, dritare	Problematikë e pjesshme – por shumë përfitues	●	3

Nuk kërkojnë ndërhyrje prioritare (pa problematika aktuale ose janë objekte të rikonstruara pas vitit 2015)

- Shkolla “Nuçi Naçi” (149 nxënës)
- Shkolla Speciale (21 nxënës)
- Shkolla “Sevasti Qiriazhi” (681 nxënës)
- Shkolla “Pandeli Cale” (344 nxënës)
- Shkolla “Naim Frashëri” (95 nxënës)
- Shkolla “Mësonjtore” (551 nxënës)
- Shkolla “Ymer Dishnica” (135 nxënës)
- Shkolla “Themistokli Gërmenji” (530 nxënës)

Analiza e prioritarizimi i ndërhyrjeve në shkollat e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë

Bashkia Korçë ka një rrjet të gjerë shkollash në zonat rurale, ku sfidat infrastrukturore dhe kushtet gjeografike ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe aksesin në arsim. Për të ndërtuar një qasje të drejtë dhe të qëndrueshme investimi, është realizuar një analizë e thelluar që kombinon: (1) **emergjencën e ndërhyrjes**, dhe (2) **numrin e përfituesve**, si dy kriteret bazë për vendosjen e prioriteteve.

A. Prioritet shumë i lartë (ndërhyrje emergjente)

Kjo kategori përfshin shkollat ku rrezikohet siguria e fëmijëve dhe e stafit, për shkak të mungesës së kushteve bazë ose problemeve të theksuara strukturore e higjieno-sanitare. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Nr	Shkolla	Nxënës	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
1	9-vjeçare Bulgarec	137	Mungesë palestere	Ndikim në mirëqenie fizike, shëndet dhe jetesë aktive për shumë nxënës	●	1
2	9-vjeçare Lumalas	82	Lageshtirë, izolim i dobët, amortizim strukturor	Rrezik për mjedisin mësimor, nevojë për ndërhyrje të menjëhershme	●	1
3	9-vjeçare Goskovë	30	Mungesë ujë të pijshëm, ËC jashtë godinës	Emergjencë higjieno-sanitare, cenon dinjitetin dhe shëndetin e fëmijëve	●	1

Në këto shkolla, ndërhyrjet sugjerohet të jenë prioritare që në vitin e parë të zbatimit të planit.

B: Prioritet i lartë

Kjo kategori përfshin shkollat ku mungesa e rrethimeve, e sigurisë fizike, pajisjeve bazë apo nevoja për termoizolim dhe kushte sanitare, nuk përbën rrezik të menjëhershëm, por ndikon dukshëm në cilësinë e procesit mësimor dhe jetesës shkollore. Lista përfshinë:

Nr	Shkolla	Nxënës	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
4	"Xhavit Dishnica", Dishnicë	74	Rrezik për themelet, mungesë termoizolimi	Nevojë për ndërhyrje parandaluese për të shmangur amortizimin afatgjatë	●	2
5	"Isuf Dalipi", Mollaj	122	Rrethim i amortizuar, mungesë izolimi	Shkollë me mbi 100 nxënës; ndërhyrja përmirëson sigurinë dhe kushtet termike	●	2
6	9-vjeçare Belorta	58	Tualetet të amortizuara, gropë septike e mbushur	Rrezik sanitar, veçanërisht për nxënësit më të vegjël	●	2
7	9-vjeçare Kuç i Zi	25	Çati e re, por mungesë suvatimi, rrethim i amortizuar, mungesë tualeti	Kompleksitet i nevojave për rikonstrukcion bazik dhe kushte minimale higjienike	●	2
8	9-vjeçare Pandi Guri Visi, Çiflig	20	Mungesë totale e rrethimit	Siguria e fëmijëve në fshat periferik, mungesë bazike që ndikon sigurinë fizike	●	2

Këto shkolla rekomandohen për përfshirje në vitin e dytë të planit 2027, pas adresimit të emergjencave.

C: Prioritet i mesëm

Në këtë grup përfshihen shkollat me pak nxënës, me problematika të kufizuara në mirëmbajtje (bojatisje, lyerje, ndonjë riparim) që nuk ndikojnë rëndë në siguri apo proces mësimor. Për shembull:

Nr	Shkolla	Nxënës	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
9	9-vjeçare "Rakip Koçibelli"	33	Lyerje	Mund të realizohet me mirëmbajtje periodike	●	3
10	9-vjeçare Gjonmadh	13	Lyerje	Popullsia e vogël, investim minimal	●	3

11	9-vjeçare Floq	20	Lyerje	Nuk ndikon në siguri, as në cilësinë mësimore		3
12	9-vjeçare Panarit	14	Lyerje	Përdorim i kufizuar, zgjidhje me fonde të vogla		3

Shkollat në këtë kategori mund të përfshihen në programet e mirëmbajtjes rutinë të çdo viti.

Nuk kërkojnë ndërhyrje prioritare

Shkollat që janë të rikonstruara pas vitit 2015 ose janë shkolla të reja pa asnjë problem të raportuar, nuk kërkojnë fonde kapitale në periudhën afatshkurtër. P.sh.:

- Shkolla 9-vjeçare Marjan (shkollë e re 2012)
- Shkolla “6 Dëshmorët”, Kamenicë (shkollë e re 2017)
- Shkolla “Sadik Dilka”, Voskop
- Shkolla Lekas, Pulahë

Rekomandim për vendimmarrje dhe planifikim të ndërhyrjeve për përmirësimin e infrastrukturës në shkolla:

1. **2026 – 2027 Faza 1 – Emergjencat strukturore dhe të sigurisë:** Të përfshihen të gjitha shkollat e kategorisë A
2. **2027 – 2028 Faza 2 – Përmirësim i kushteve funksionale dhe energjetike:** Të përfshihen shkollat e Kategorisë B.
3. **2026 – 2028 Faza 3 – Mirëmbajtje estetike dhe aksesorie:** Të përfshihen ndërhyrjet të kategorisë C dhe mirëmbajtjet rutinë.

6. Analiza dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve në kopshtet e Bashkisë Korçë

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës së institucioneve të arsimit parashkollor në Bashkinë Korçë, është kryer një analizë e detajuar mbi gjendjen fizike të godinave të kopshteve, nevojat emergjente për ndërhyrje, si dhe numrin e fëmijëve përfitues. Kjo analizë është bazuar në një metodologji që merr në konsideratë dy elemente kyçe:

- **Emergjencia e problematikës infrastrukturore**, ku përfshihen mungesa e kushteve bazë të sigurisë, funksionalitetit, higjienës dhe aksesit për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- **Numri i fëmijëve të regjistruar**, si një tregues i ndikimit të ndërhyrjes.

Metodologjia e prioritarizimit

Kategoria	Emergjencë	Numri i fëmijëve	Prioritet
 A – Shumë i lartë	Po	>100	1
 B – i lartë	Po	>50	2
 C – i mesëm	Po / S'ka	≤50	3
 – Pa problematika	Jo	-	Jo prioritare

Prioritarizimi i ndërhyrjeve në kopshtet e Bashkisë të Korçës

■ A – Prioritet shumë i lartë (4 kopshte)

Këto kopshte paraqesin rrezik për sigurinë e fëmijëve për shkak të lagështirës së avancuar, mungesës së sinjalistikës emergjente, rrjeteve të amortizuara elektrike dhe hidrosanitare, si dhe numrit të lartë të përfituesve.

Nr	Kopshti	Nr fëmijësh	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
1	Kopshti nr. 1	105	Lagështirë, mungesë sinjalistike	Rrezik për shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve	■	1
2	Kopshti nr. 2	99	Rrjet elektrik dhe hidraulik i amortizuar	Infrastruktura e amortizuar – kërkon ndërhyrje të plotë	■	1
3	Kopshti nr. 4	95	Hidroizolim i dobët, mungesë dalje emergjente	Mungesë sigurie në rast zjarri, nevojë për instalime të reja	■	1

■ B – Prioritet i lartë (7 kopshte)

Këto kopshte kanë problematika të rëndësishme, por nuk paraqesin rrezik të menjëhershëm për jetën ose shëndetin e fëmijëve. Nevojitet ndërhyrje për të garantuar funksionim cilësor dhe aksesueshmëri.

Nr	Kopshti	Nr fëmijësh	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
5	Kopshti nr. 5	103	Lagështirë, dalje emergjente të pamjaftueshme	Rrezik në raste të emergjencave	■	2
6	Kopshti nr. 3	96	Nevojë për zgjerim të kapacitetit	Oborr i papërshtatshëm, mungesë kënd lojërash	■	2
7	Kopshti nr. 9	110	Suvatime, sinjalistikë zjarri	Numër i madh përfituesish	■	2
8	Kopshti nr. 10	70	Probleme me sinjalistikën dhe muret	Rrezik nga zjarri	■	2
9	Kopshti nr. 11	75	Mungesë e rampave dhe daljeve të sigurta	Akses i pamundur për fëmijët me AK	■	2
10	Kopshti nr. 8	57	Restaurim i plotë	Godinë e amortizuar	■	2
11	Kopshti nr. 12	86	Probleme me aksesin dhe mbrojtjen nga zjarri	Nevojë për standardizim të kushteve	■	2

C – Prioritet i mesëm (2 kopshte)

Problematikat janë të natyrës më të lehtë ose kanë një numër më të ulët fëmijësh.

Nr	Kopshti	Nr fëmijësh	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
12	Kopshti nr. 13	46	Mungesë sinjalistike	Nevojë për pajisje sigurie		1
13	Kop. Vithkuq	-	Çarje muri, tavan i dëmtuar	Problem lokal, kërkon riparime		1

Pa problematika prioritare (2 kopshte)

Këto kopshte janë në gjendje të mirë infrastrukturore.

Nr	Kopshti	Nr fëmijësh	Problematika Kryesore	Arsyetimi	Emergjencë	Prioritet
14	Kopshti nr. 6	37	Nuk ka problematika	Gjendje e mirë funksionale		

Rekomandime për investime

- **Faza I – 2026 - 2027:** Ndërhyrje të menjëhershme në 4 kopshtet me prioritet shumë të lartë.
- **Faza II – 2027 - 2028:** Realizimi i ndërhyrjeve në 7 kopshtet me prioritet të lartë.
- **Faza III – 2026 – 2028** Ndërhyrje funksionale dhe estetike në 2 kopshte me prioritet të mesëm.
- **Monitorim dhe mirëmbajtje:** Mbajtja e inspektimeve periodike dhe buxhetimi për mirëmbajtje vjetore për 2 kopshtet pa problematika në vit.

Në këtë mënyrë sigurohet një kalendar investimesh i menaxhueshëm, i orientuar drejt sigurisë, përfshirjes dhe standardizimit të infrastrukturës së arsimit parashkollor në Bashkinë Korçë.

7. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar



0

Vizioni

“Të garantojmë akses të barabartë, cilësi të lartë dhe përfshirje të plotë në arsimin parauniversitar për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Korçë – duke përmirësuar e modernizuar shërbimin në shkolla dhe kopshte si qendra komunitare që formësojnë qytetarë të denjë, të ditur dhe socialisht të ndërgjegjshëm”

0

Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve

Duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të institucioneve arsimore, nga kopshtet deri në shkollat e mesme dhe duke adresuar sfidat aktuale të aksesit, infrastrukturës dhe përfshirjes gjinore, Bashkia Korçë ka për synim:

- **Vlerësimin dhe përmirësimin e infrastrukturës arsimore**, për të garantuar kushte dinjitoze mësimi në çdo shkollë e kopsht;
- **Përmirësimin e përfshirjes në arsimin parashkollor**, duke mbështetur prindërit duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit të hershëm;
- **Forcimi i përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta**, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- **Rritjen e cilësisë së mësimdhënies**, përmes investimit në zhvillimin profesional të mësuesve të arsimit parashkollor dhe përdorimin e metodologjive bashkëkohore;
- **Forcimin e partneriteteve me komunitetin dhe institucionet arsimore** për të mbështetur suksesin e çdo nxënësi.

- **Mbledhja më e plotë e të dhënave** në terren për komunitetet rome dhe egjiptiane për të vlerësuar nëse ka nevojë për ndërhyrje proaktive.
- **Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komunitetit**
 - o **Fushata informuese dhe edukative për prindërit**, veçanërisht në lagje ose fshatra ku ka mungesë informacioni mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.
 - o **Bashkëpunim me punonjësit socialë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës** për të identifikuar dhe mbështetur familjet që nuk i dërgojnë fëmijët në kopsht për arsye ekonomike, kulturore ose sociale.
 - o **Angazhimi i këshillave të prindërve dhe organizatave lokale**, për të fuqizuar përfshirjen dhe monitorimin e komunitetit.

Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, modern dhe gjithëpërfshirës në çdo institucion shkollor dhe parashkollor të Bashkisë Korçë

Bashkia Korçë synon të garantojë kushte infrastrukturore të qëndrueshme dhe funksionale për çdo institucion arsimor në territorin e saj, përmes mirëmbajtjes së rregullt dhe investimeve që përmbushin standardet bashkëkohore të sigurisë, higjienës dhe funksionalitetit.

- **Objektivi 1.1:** Të garantohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse të qëndrueshme dhe efektive në institucionet e arsimit parauniversitar gjatë periudhës 2026–2028, duke përfshirë mbulimin me staf edukativ dhe mbështetës në 49 kopshte dhe 57 shkolla çdo vit, sigurimin e furnizimeve bazë (mjete didaktike, kancelari, dokumentacion), përmirësimin e kushteve higjiëno-sanitare të institucioneve, funksionimin e sistemit të ngrohjes në të gjitha objektet, si dhe mirëmbajtjen infrastrukturore të 100% të godinave publike arsimore, me fokus të veçantë në mbështetjen e fëmijëve nga grupet vulnerabël.
- **Objektivi 1.2:** Të realizohen deri në fund të vitit 2028 investime prioritare për punime rikonstruksioni, mirëmbajtje dhe pajisje të të paktën 26 institucione të arsimit parauniversitar (kopshte, shkolla bazë dhe të mesme) në territorin e Bashkisë Korçë, si dhe të ndërtohet dhe funksionalizohet një sistem dixhital për menaxhimin dhe përditësimin e të dhënave institucionale për të tre nivelet e arsimit (parashkollor, bazë, i mesëm), duke garantuar akses, transparencë dhe përmirësim të planifikimit dhe shërbimeve.

Qëllimi 2 (Q2) Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar në një sistem gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre

Përmes një qasjeje të balancuar mes edukimit, përkujdesjes dhe përfshirjes sociale, Bashkia Korçë synon të nxisë zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve, veçanërisht të atyre që përballen me barrierë sociale, ekonomike apo zhvillimore.

- **Objektivi 2.1:** Të përmirësohet cilësia e edukimit në institucionet e arsimit parashkollor dhe fillor në Bashkinë Korçë deri në vitin 2028, përmes pajisjes së të gjithë kopshteve me materiale didaktike bashkëkohore dhe trajnimit të vazhdueshëm të të gjithë edukatorëve dhe drejtuesve të ciklit parashkollor, në funksion të garantimit të një mjedisi mbështetës, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt zhvillimit të hershëm të fëmijëve.
- **Objektivi 2.2:** Të zgjerohet progresivisht mbulimi me shërbime psiko-sociale dhe mësues ndihmës në të gjitha institucionet parashkollore, duke garantuar deri në vitin 2028 përfshirje të plotë të kopshteve dhe mbështetje individuale për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara ose në rrezik social.
- **Objektivi 2.3:** Deri në fund të vitit 2028, të forcohet bashkëpunimi shkollë–familje–komunitet përmes ngritjes dhe funksionalizimit të strukturave përfaqësuese dhe zhvillimit të

aktiviteteve gjithëpërfshirëse, duke synuar përfshirjen rregullisht të të paktën 75% të prindërve në këshilla, organizimin e të paktën 3 fushatave vjetore në zonat me përfshirje të ulët dhe reflektimin e të paktën 15 propozimeve të komunitetit në planet institucionale.

Qëllimi 3 (Q3) Të fuqizohet zhvillimi gjithëpërfshirës i fëmijëve përmes nxitjes së aftësive krijuese, sociale dhe sipërmarrëse, nëpërmjet programeve jashtëkurrikulare edukative, kulturore, sportive dhe teknologjike, në bashkëpunim me Qytezën e Fëmijëve dhe komunitetin.

Bashkia Korçë e konsideron edukimin përmes kulturës, artit, sportit dhe përvojave sociale si pjesë të pandashme të zhvillimit të fëmijëve dhe forcimit të lidhjes së tyre me komunitetin lokal.

- **Objektivi 3.1:** Deri në fund të vitit 2028, të krijohet dhe të zbatohet një kalendar i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës me të paktën 12 aktivitete vjetore në institucionet e arsimit parauniversitar në Bashkinë Korçë
- **Objektivi 3.2:** Të zgjerohet bashkëpunimi me institucionet kulturore, sportive dhe artistike në Bashkinë Korçë për të organizuar çdo vit të paktën 5 aktivitete masive edukative gjithëpërfshirëse, që angazhojnë të paktën 600 fëmijë (vajza dhe djem) në veprimtari që nxisin leximin, lëvizjen fizike, kreativitetin dhe ndjenjën e përkatësisë.

Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028)

Plani i arsimit parauniversitar i Bashkisë Korçë parashikon ndërhyrje me investime kapitale të rëndësishme, të cilat synojnë përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës arsimore dhe forcimin e kapaciteteve teknike e pedagogjike të institucioneve.

Gjatë periudhës 2026–2028, investimet do të fokusohen në rikonstruksionin e shkollave të arsimit bazë, parashkollor dhe të mesëm, pajisjen e ambienteve me infrastrukturë moderne, si dhe ngritjen e kushteve të përshtatshme për mësimdhënie dhe zhvillim gjithëpërfshirës të nxënësve. Me një fond total që i kalon 139 milionë lekë, plani kapital synon të garantojë ambiente të sigurt, funksionale dhe të përshtatshme për nevojat e fëmijëve dhe të rinjve në çdo nivel të arsimit parauniversitar. Këto ndërhyrje janë pjesë e një vizioni afatgjatë për transformimin e shkollës në një hapësirë që promovon cilësi, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm arsimor në territorin e Bashkisë Korçë.

Një nga projektet më të mëdha financiare është rikonstruksioni i shkollave të arsimit bazë dhe parashkollor, me një total prej 70.6 milionë lekësh të shpërndarë në tre vite (24.6 milionë në 2026, 23 milionë në 2027 dhe po aq në 2028). Ky investim synon të përmirësojë ndjeshëm mjediset mësimore dhe të rrisë sigurinë dhe funksionalitetin e institucioneve.

Përveç rikonstruksionit, janë planifikuar edhe investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit bazë dhe parashkollor, me një total prej 49.4 milionë lekësh, përfshirë mjete didaktike, teknologji mësimore dhe mobilie moderne që përmirësojnë përvojën edukative të nxënësve dhe fëmijëve të kopshteve.

Në nivelin e arsimit të mesëm parauniversitar, plani parashikon rikonstruksion të shkollave me një fond total prej 16.36 milionë lekësh, të shpërndarë në mënyrë të barabartë për tre vite. Ky projekt do të fokusohet në rritjen e cilësisë së ambienteve të të nxënësve në gjimnaze dhe shkolla profesionale.

Së fundi, janë parashikuar 2.93 milionë lekë për pajisje duke përfshirë infrastrukturën mbështetëse dhe ndihmëse në të gjitha nivelet, që ndihmon në plotësimin e nevojave specifike të çdo institucioni.

Këto investime paraqesin një angazhim të qartë të Bashkisë Korçë për modernizimin e sistemit arsimor lokal dhe për përmirësimin e cilësisë së edukimit në të gjithë territorin e saj, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe nevojat e komunitetit.

8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve me aftësi ndryshe dhe nga grupe vulnerable.

- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimit për nxënësit e arsimit profesional që frekuentojnë dhe konviktet;
- Funksionimin e Qendrës kulturore të fëmijëve ose njësi të tjera mbështetëse të edukimit jashtëshkollor, duke përfshirë paratë e personelit mësues dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

Për periudhën 2025–2028, buxheti total i planifikuar për Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor është 1,991,685 mijë lekë, të detajuara sipas aktiviteteve më poshtë:

Aktivitetet	Viti 2025 në mijë Lekë	Viti 2026 në mijë Lekë	Viti 2027 në mijë Lekë	Viti 2028 në mijë Lekë	Shuma në mijë Lekë
<i>Shpenzime per paga</i>	292,079	296,228	299,190	302,182	1,189,679
<i>Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore</i>	50,008	50,952	51,649	52,500	205,109
<i>Shpenzime operative</i>	106,123	107,100	108,200	109,300	430,723
<i>Shpenzime per investime</i>	46,174	40,000	40,000	40,000	166,174
Shuma në mijë Lekë	494,384	494,280	499,039	503,982	1,991,685

Për periudhën 2025–2028, buxheti total i planifikuar për Arsimin e mesëm të përgjithshëm është 320,910 mijë lekë, të detajuaja sipas aktiviteteve më poshtë:

Aktivitetet	Viti 2025 në mijë Lekë	Viti 2026 në mijë Lekë	Viti 2027 në mijë Lekë	Viti 2028 në mijë Lekë	Shuma në në mijë Lekë
<i>Shpenzime per paga</i>	38,370	38,753	39,141	39,532	155,796
<i>Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore</i>	6,407	6,472	6,536	6,602	26,017
<i>Shpenzime operative</i>	23,710	23,865	24,337	24,564	96,476
<i>Transferta tek Individet</i>	4,530	4,500	4,500	4,500	18,030
<i>Shpenzime per investime</i>	5,300	5,931	6,680	6,680	24,591
<i>Shuma në mijë Lekë</i>	78,317	79,521	81,194	81,878	320,910

9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, modern dhe gjithëpërfshirës në çdo institucion shkollor dhe parashkollor të Bashkisë Korçë

Objektivi specifik O1. Të garantohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse të qëndrueshme dhe efektive në institucionet e arsimit parauniversitar gjatë periudhës 2026–2028, duke përfshirë mbulimin me staf edukativ dhe mbështetës në 49 kopshte dhe 57 shkolla çdo vit, sigurimin e furnizimeve bazë (mjete didaktike, kancelari, dokumentacion), përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare të institucioneve, funksionimin e sistemit të ngrohjes në të gjitha objektet, si dhe mirëmbajtjen infrastrukturore të 100% të godinave publike arsimore, me fokus të veçantë në mbështetjen e fëmijëve nga grupet vulnerabël.						
Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjësi	Partnerë	Burimet financiare	Tregues	Vlera e synuar:
Mbështetja me pagesën dhe sigurimin punonjësve të arsimit (parashkollor, bazë dhe atij të mesëm)	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	Transferte specifike + Buxhet vendor	Numri i kopshteve të mbështetura me staf edukativ dhe mbështetës;	49 kopshte janë mbështetur me staf në vitin 2026; 49 në 2027; 49 në 2028
					Numri i personelit edukativ në arsimin parashkollor	Në vitin 2026: 134 edukatorë / 4 ndihmës edukatorë; Në vitin 2027: progresivisht rritje e shërbimit sipas nevojës; Në vitin 2028: progresivisht rritje e shërbimit sipas nevojës;
					Numri i stafit për shërbimet mbështetëse në institucionet arsimore parashkollore (roje, pastrues, ndihmës teknikë, etj.)	156 staf për shërbimet mbështetëse në 2026; 156 në 2027; 156 në 2028;
					Raporti i mësuesve ndihmës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte	1 mësues ndihmës për çdo 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara – për secilin vit (2026–2028)

					Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte Në 2026 sipas vendimeve të Komisionit të Vlerësimit për nevojën e shërbimit për fëmijën, Në 2027 sipas vendimeve të Komisionit të Vlerësimit për nevojën e shërbimit për fëmijën. Në 2028 sipas vendimeve të Komisionit të Vlerësimit për nevojën e shërbimit për fëmijën. Disagregim: vajza/djem; nga familje në nevojë
				Numri i fëmijëve rom dhe egjiptianë të regjistruar në kopshte Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve rom dhe egjiptian të regjistruar në kopshte	
				Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm	5563/1906 Nxënës në 2026; 5563/1906 në 2027; 5563/1906 në 2028; Disagregim: shkollë, cikël, gjini, kategori
				Numri i fëmijëve rom dhe egjiptianë të regjistruar në shkolla; Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve rom dhe egjiptian të regjistruar (që frekuentojne) në shkolla	

					Raporti edukator për fëmijë në kopsht;	1 edukatore për çdo 12 fëmijë në 2026 , 1 edukator për çdo 12 fëmijë në 2027 , 1 edukator për çdo 12 fëmijë në 2028
					Numri mesatar i fëmijëve për grup	16 fëmijë/grup (2026), 16 fëmijë/kopësht (2027), 16 fëmijë/kopësht (2028)
					Numri mesatar i fëmijëve për grup në parashkollor (klasa përgatitore)	25 fëmijë/grup (2026), 25 (2027), 25 (2028)
					Numri i shkollave të mbështetura me staf mbështetës	57 shkolla në 2026; 57 shkolla në 2027; 57 shkolla në 2028;
					Numri i stafit mbështetës në institucionet arsimore shkollore (roje, pastrues, ndihmës teknikë, etj.)	156 punonjës në 2026 ; 156 në 2027 ; 156 në 2028
					Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin bazë	25 nxënës/klasë (2026), 25 (2027), 25 (2028)
					Shpenzime për shërbime mbështetëse për nxënës (në mijë lekë)	20 mijë lekë/nxënës në 2026. 20 mijë në 2027. 20 mijë 2028.
					Numri i shkollave që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të veçanta	1 shkolla në 2026, 1 në 2027, 1 në 2028
Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore Kopshte - Kopshti nr. 6 - Kopshti nr. 13,	2026–2028	Njësia përgjegje se për arsimin, Njësia përgjegjë se për	Shkollat, kopshtet	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar	Numri godinave të arsimit parashkollor ku janë bërë ndërhyrje të mirëmbajtjes (mirëmbajtje të lehta, teknike, elektrike, pajisje)	20 kopshte në 2026, 20 kopshte në 2027, 20 kopshte në 2028,

- Etj.sipas nevojës -		shërbime t publike dhe investim et;				
Shkolla: Qyteti Korçë - Gjimnazi “Tefta Tashko Koço” (9v + gjimnaz) - Gjimnazi Raqi Qirinxhi” Njësi administrative - 9-vjeçare Rakip Koçibelli - 9-vjeçare Gjonmadh - 9-vjeçare Floq - 9-vjeçare Panarit - Etj. sipas nevojës					Numri godinave të arsimiit ku janë bërë ndërhyrje të mirëmbajtjes (mirëmbajtje të lehta, teknike, elektrike, pajisje)	15 shkolla në 2026, 15 shkolla në 2027, 15 shkolla në 2028.
Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve higjieno-sanitare - Furnizim me bazë materiale të bollshme për higjienën - Shtim i stafit mbështetës në institucionet arsimore, aty ku paraqitet e nevojshme	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbime t publike	Shkollat, Kopshtet , operatorë të higjienës ,	Buxhet vendor, transfertë e pakushtëzuar	Nr. i shkollave me kushte higjieno-sanitare të përmirësuara sipas standartit	57 shkolla në 2026, 57 shkolla në 2027, 57 shkolla në 2028,
					Nr. i kopshteve me kushte higjieno-sanitare të përmirësuara sipas standartit	49 kopshte në 2026, 49 kopshte në 2027, 49 kopshte në 2028,
Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për	Operator ë të energjisë ,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i kopshteve me sistem funksional ngrohjeje	49 kopshte në 2026, 49 kopshte në 2027, 49 kopshte në 2028
					Nr. i shkollave me sistem funksional ngrohjeje	57 shkolla në 2026, 57 shkolla në 2027, 57 shkolla në 2028,

		shërbime t publike				
Furnizimi me kancelari për të gjitha institucionet arsimore	2026– 2028	Njësia përgjegje së për arsimin,	Shkollat Kopshtet	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i kopshteve të furnizuara me kancelari sipas nevojës	49 kopshte në 2026, 49 kopshte në 2027, 49 kopshte në 2028,
					Nr. i shkollave të furnizuara me kancelari sipas nevojës	57 shkolla në 2026, 57 shkolla në 2027, 57 shkolla në 2028,
Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit në çdo institucion arsimor	2026– 2028	Zyra e Emergjencave	Zjarrfikësja, NjA	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i fikseve të vendosura dhe funktionale në kopshte dhe shkolla	49 + 57 fikse zjarri në 2026, 49 + 57 fikse zjarri në 2027, 49 + 57 fikse zjarri në 2028,
					Nr. i kopshteve të pajisur me fikse zjarri	49 kopshte të pajisur me fikse zjarri në 2026, 49 kopshte në 2027, 49 kopshte në 2028,
					Nr. i shkollave të pajisur me fikse zjarri	57 shkolla të pajisur me fikse zjarri në 2026, 57 shkolla në 2027, 57 shkolla në 2028,
Furnizimi me dokumentacion administrativ për të gjitha institucionet arsimore - Regjistra zyrtarë (hyrje-dalje, ndjekje të fëmijëve, pjesëmarrje ditore); - Dosje të personalizuar për çdo fëmijë (portfolio zhvillimi, dokumentim progresi); - Regjistra të veçantë për fëmijët me nevoja të veçanta;	2026– 2028	Njësia përgjegje së për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion;	57 shkolla të pajisur me dokumentacion në 2026, 57 kopshte në 2027, 57 kopshte në 2028,
					Nr. i kopshteve të pajisura me dokumentacion	49 kopshte të pajisur me dokumentacion në 2026, 49 kopshte në 2027, 49 kopshte në 2028,

• Dokumentacion për menaxhimin e stafit (orare, vlerësim performance, pushime); • Formate për takime me prindër dhe dokumentim i pjesëmarrjes së tyre; • Manuale dhe udhëzues të printuar për përdorim nga edukatorët; • Formularë për ndjekje psiko-sociale (nëse është ngritur shërbimi përkatës); • Librat e bordit dhe këshillave prindërorë (procesverbale, vendime, etj.); • Formularë raportimi për ngjarje të veçanta, siguri dhe shëndet.						
Furnizimi me mjete didaktike për të gjitha institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegje së për arsimin,	Kopshtet MAS	Buxhet vendor + donacione, prindërit	Nr. i kopshteve të pajisura me mjete didaktike	49 kopshte të pajisur mjete didaktike në 2026, 49 kopshte në 2027, 49 kopshte në 2028,
Furnizimi dhe shërbimi ushqimor në institucionet e arsimit parashkollor - Në bashkinë Korçë të gjithë mensat janë funksionale. - Shtimi i numrit të fëmijëve që marrin këtë shërbim, sipas kërkesës dhe pas realizimit të një analize të nevojës.	2026–2028	Zyra Shëndetit Publik & Arsimit	Operatorët e licencuar , Ministria e Arsimit, Sportit (MAS)	Buxhet vendor	Nr. i kopshteve që ofrojnë shërbimin e vakteve ushqimore	8 kopshte që ofrojnë shërbimin e vakteve ushqimore në 2026, 8 kopshte në 2027, 8 kopshte në 2028,
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegje	Instituti i Shëndetit	Buxhet vendor +	Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit për çdo	49 + 57 i dezinfektime të kryera në vit për çdo

		së për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar	fond emergjenc e	institucion arsimor (kopsht/shkollë)	institucion arsimor (kopsht/shkollë) në vitin 2026; 49 +57 në vitin 2027; 49 +57 në vitin 2028;
--	--	--	---	------------------	--------------------------------------	---

Objektivi specifik O1.2 Të realizohen deri në fund të vitit 2028 investime prioritare për punime rikonstruksioni dhe pajisje të të paktën 26 institucioneve të arsimit parauniversitar (kopshte, shkolla bazë dhe të mesme) në territorin e Bashkisë Korçë, si dhe të ndërtohet dhe funksionalizohet një sistem dixhital për menaxhimin dhe përditësimin e të dhënave institucionale për të tre nivelet e arsimit (parashkollor, bazë, i mesëm), duke garantuar akses, transparencë dhe përmirësim të planifikimit dhe shërbimeve.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjësi	Partnerë	Burimet financiare	Tregues	Vlera e synuar:
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit parashkollor; - Rikonstruksion i godinave të arsimit parashkollor Faza I-rë: (2026 – 2027) - Kopshti nr. 1 - Kopshti nr. 2 - Kopshti nr. 4 Faza II-të (2027-2028) - Kopshti nr. 5 - Kopshti nr. 3 - Kopshti nr. 9 - Kopshti nr. 10 - Kopshti nr. 11 - Kopshti nr. 8 - Kopshti nr. 12	Çdo vit 2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore Donatorë	Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruara; Përqindja (%) e kopshteve që plotësojnë standardet minimale të aksesit fizik për fëmijët me aftësi të kufizuara (rampë hyrëse dhe tualet i përshtatur), ndaj numrit total të institucioneve arsimore përkatëse në territorin e bashkisë.	3 institucione arsimore parashkollore të rikonstruara në 2026; 3 në 2027 4 në 2028 në 2026 50% e kopshteve plotësojnë standardet minimale të aksesit; në 2027, 60%; në 2028, 70%;

Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit bazë dhe të mesëm <i>Rikonstruksion i shkollave të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm</i> Faza I-rë:(2026 – 2027) Qyteti Korçë: - 9 – vjeçare “Demokracia” - 9 – vjeçare “Naum Veqilharxhi” - 9 – vjeçare “Ismail Qemali” - 9 – vjeçare “Sotir Gurra” - Gjimnazi “Faik Konica” Njësi administrative - 9-vjeçare Bulgarec - 9-vjeçare Lumalas - 9-vjeçare Goskovë Faza e II-të:(2027 – 2028) Qyteti Korçë - Shkolla 9 – vjeçare “Stavri Themeli” - Shkolla 9 – vjeçare “Asdreni” - Konvikti i gjuhëve të huaja Njësi administrative - "Xhavit Dishnica", Dishnicë. - "Isuf Dalipi", Mollaj - 9-vjeçare Belorta - 9-vjeçare Kuç i Zi - 9-vjeçare Pandi Guri Visi, Çiflig	Çdo vit 2026– 2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbime t publike dhe investim et	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore, Donatorë	Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktura; Nr. i institucioneve të arsimit të mesëm të rikonstruktura; Përqindja (%) e shkollave që plotësojnë standardet minimale të aksesit fizik për fëmijët me aftësi të kufizuara (rampë hyrëse dhe tualet i përshtatur), ndaj numrit total të institucioneve arsimore përkatëse në territorin e bashkisë.	7 institucione të arsimit bazë të rikonstruktura në 2026 - 2027; 7 në 2027 - 2028 01 institucione të arsimit të mesëm të rikonstruktura në 2026 – 2027 1 konvikt i gjuhëve të huaja në 2026 50% shkolla plotësojnë standardet minimale të aksesit; në 2027, 60%; në 2028, 70%;
---	--------------------------	---	-------------------------------------	--	--	---

Blerje mobilje për kopshtet - Grupet e kopshteve pajisen me mobilje të reja	2026	Drejtoria e Arsimit	Drejtorit ë e shkollave/kopshteve	Buxheti i Bashkisë	Nr. i klasave/grupeve të kopshteve të mobiluara rishtas	20 klasave të kopshteve të mobiluara rishtazi në 2026; 20 në 2027 20 në 2028
Blerje mobilje për shkollat - Klasat në shkollat pajisen me mobilje të reja	2026	Drejtoria e Arsimit	Drejtorit ë e shkollave/kopshteve	Buxheti i Bashkisë, Buxheti Ministria e arsimit dhe Sportit	Nr. i klasave në shkolla të mobiluara rishtas	106 klasave të shkollave të mobiluara rishtazi në 2026; 106 në 2027 106 në 2028
Investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit parauniversitar sipas nevojës	Çdo vit 2026–2028	Drejtoria e Arsimit	Drejtorit ë e shkollave/kopshteve	Buxheti i Bashkisë, Buxheti Ministria e arsimit dhe Sportit	Nr i pajisjeve në kopshte Nr. i. pajisjeve në shkolla	
Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për kopshtet dhe shkollat në kuadër të planit për përmirësim të arsimit parauniversitar	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Kopshtet /shkollat; Ekspertë të jashtëm për mbështetje	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë), 0	Nr i regjistrave të shërbimit të arsimit sipas kategorisë të krijuar dhe përditësuar më të dhëna çdo vit	Një regjistër i shërbimit për arsimin parashkollor mesëm i krijuar, dhe i përditësuar çdo vit me të dhëna, Një regjistër i shërbimit për arsimin bazë i krijuar, dhe i përditësuar çdo vit me të dhëna; Një regjistër i shërbimit për arsimin e mesëm i krijuar, dhe i përditësuar çdo vit me të dhëna

Qëllimi 2 (Q2) – Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar në një sistem gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre

Objektivi specifik O2.1 Të përmirësohet cilësia e edukimit në institucionet e arsimit parashkollor dhe fillor në Bashkinë Korçë deri në vitin 2028, përmes pajisjes së të gjithë kopshteve me materiale didaktike bashkëkohore dhe trajnimit të vazhdueshëm të të gjithë edukatorëve dhe drejtuesve të ciklit parashkollor, në funksion të garantimit të një mjedisi mbështetës, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt zhvillimit të hershëm të fëmijëve.						
Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues	Vlera e synuar:
Pajisje me materiale didaktike, kompjuterë dhe trajnime për edukatorët	Çdo vit	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MAS, partnerë zhvillimi	Buxhet vendor, partnerë	Përqindja e fëmijëve që përfitojnë nga përdorimi i mjeteve didaktike (vajza/djem; nga familje në nevojë)	Viti 2026: 100 % e fëmijëve; me fokus fillestar në kopshte urbane dhe zona me densitet më të lartë Viti 2027 100 % e fëmijëve; shtrirje në shumicën e kopshteve në territor Viti 2028: 100 % e fëmijëve; mbulim – të gjithë fëmijët në kopshte të pajisur dhe përfshirë në përdorim aktiv të mjeteve didaktike
					Nr. i kopshteve të pajisura me mjete didaktike moderne	Viti 2026: 49 kopshte Fokus në kopshte urbane dhe ato me numër të lartë fëmijësh; priorizohen zonat me më shumë nevoja ose me

						më shumë fëmijë nga grupe vulnerabël Viti 2027: 49 kopshte Zgjerim i mbulimit në Njësitë Administrative me popullsi të përqendruar rurale dhe nevoja specifike zhvillimore Viti 2028: 49 kopshte 100% mbulim – të gjitha kopshtet në territorin e bashkisë të pajisura me mjete didaktike moderne dhe të përshtatura për zhvillimin e hershëm
					Përqindja e kopshteve që raportojnë përmirësim në praktikat didaktike pas pajisjeve	Viti 2026: 70% Faza e parë e implementimit – përmirësimet raportohen në një pjesë të kopshteve të pajisura, bazuar në vlerësime të brendshme dhe feedback nga edukatorët Viti 2027 80% Rritje graduale e përfshirjes dhe përdorimit efektiv të mjeteve në praktikat mësimore

						Viti 2028 90–100% Konsolidim i përvojës dhe përhapje e praktikave të përmirësuar në të gjitha kopshtet e mbuluara nga investimi
Fuqizimi i kapaciteteve të stafit arsimor të institucioneve parashkollore, në funksion të garantimit të një edukimi cilësor dhe mbështetës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MASR, institucionet arsimore, OSHC, ASKAP	Buxhet vendor, projekte me financim të huaj	Përqindja edukatorëve të trajnuara; Përmirësimi i praktikave të administrimit të kopshtit dhe të mësimdhësnies;	Viti 2026: 100% Edukatorët pjesëmarrës në trajnime bazë për përdorimin e mjeteve didaktike moderne dhe qasje gjithëpërfshirëse Viti 2027: 100% Rritje e numrit të trajnuarve dhe përfshirje e moduleve për vëzhgim dhe reflektim mbi praktikën
					Përqindja e kopshteve që raportojnë përmirësim në praktikën	Viti 2028: 100% Të gjithë edukatorët trajnohen dhe dokumentojnë përmirësime në përdorimin e metodologjive aktive, gjithëpërfshirëse dhe të orientuara drejt fëmijës Viti 2026: 60% Kopshte që raportojnë përmirësim në planifikim, organizim aktivitetesh dhe

					didaktike pas trajnimeve	përdorim të mjeteve të reja didaktike. Viti 2027: 70% Përmirësimi i qëndrueshëm në metodologji mësimore, përfshirje aktive të fëmijëve dhe vlerësim formativ. Viti 2028: 90-100% Të gjitha kopshtet raportojnë ndryshim pozitiv të vërejtur nga drejtuesit, edukatorët dhe prindërit përmes vlerësimeve të strukturuar
--	--	--	--	--	--------------------------	---

Objektivi specifik O2.2 Të zgjerohet progresivisht mbulimi me shërbime psiko-sociale dhe mësues ndihmës në të gjitha institucionet parashkollore, duke garantuar deri në vitin 2028 përfshirje të plotë të kopshteve dhe mbështetje individuale për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara ose në rrezik social.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues	Vlera e synuar:
Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte - <i>Plotësimi i nevojave për mësues ndihmës (një për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara ose me vështirësi në të nxënë)</i>	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore	OJQ sociale, MAS	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Raporti i mësuesve ndihmës ndaj numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore parashkollore;	1 mësues ndihmës për çdo 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara në vitin 2026; 1 mësues ndihmës për çdo 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara në vitin 2027; 1 mësues ndihmës për 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara në vitin 2028;
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin	Administratorët e Njësive Administrative; këshilli bashkiak; Kopshtet; Prindërit	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. Bordeve të shkollave të institucionalizuara dhe funksionale (urbane, NjA);	Deri në fund të vitit 2026: 100% e shkollave të kenë të ngritur strukturën menaxhuese (Bordin e institucionit).
					Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të	Në 2026: $\geq 30\%$ e përfaqësuesve të jenë baballarë Në 2027: $\geq 40\%$ Në 2028: $\geq 50\%$

					kopshteve dhe shkollave;	
					Nr. Bordeve të kopshteve të institucionalizuar dhe funksionalë (urbane, NjA);	2026: Borde funksionale të kopshteve në të paktën 70% të kopshteve (urbane + NjA) 2027: $\geq 80\%$ 2028: 90%-100%
					Struktura menaxhuese në të gjitha kopshte dhe shkolla aktive	Viti 2027 - 2028: Bordet e institucioneve jenë aktive dhe të funksionojnë me mbledhje periodike, të dokumentuar
Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte Ngritja dhe fuqizimi i shërbimit psiko-social në institucionet parashkollore në varësi të Bashkisë Në Bashkinë Korçë për shërbimin e arsimit parashkollor ka vetëm psikologe dhe nuk ka punonjëse sociale	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Kopshtet; OSHC	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Numri i kopshteve që kanë të paktën një punonjës social të dedikuar	Viti 2026: Të angazhohen psikologë dhe punonjës socialë në 13 kopshte (me prioritet zonat urbane dhe Njësitë Administrative me risk social më të lartë); Viti 2027: Shtrirja e shërbimit në 20 kopshte në territorin e bashkisë; Viti 2028: Të mbulohen të gjitha 30

						kopshtet përmes kombinimit të psikologëve dhe punonjësve socialë.
					Numri i rasteve të ndjekura në mënyrë të strukturuar për fëmijët nga grupe vulnerabël	Viti 2026: 100% raste të referuara të ndjekura; Viti 2027: 100% raste të referuara të ndjekura; Viti 2028: 100% raste të referuara të ndjekura;
					Numri i takimeve me prindërit të organizuara nga shërbimi psiko-social	Viti 2026: 49 takime me teme të përcaktuara: Minimalisht 1 takim për çdo kopsht (takime shitesë sipas nevojës) Viti 2027: 49 takime me teme të përcaktuara: Minimalisht 1 takim për çdo kopsht (takime shitesë sipas nevojës) Viti 2028: 49 takime me teme të përcaktuara: Minimalisht 1 takim për çdo kopsht (takime shitesë sipas nevojës)

Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur me shërbime (sociale, arsimore, etj)	Viti 2026: 100% raste të nxënësve referuara të ndjekura dhe të mbështetura; Viti 2027: 100% raste të nxënësve referuara të ndjekura dhe të mbështetura; Viti 2028: 100% raste të nxënësve referuara të ndjekura dhe të mbështetura; Mbështetje e integruar: materiale, ndihmë sociale, përfshirje në aktivitete.
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	MAS, mësues, komuniteti	Buxhet vendor + shpërblime nga MAS	Nr. i nxënësve (vajza/djem) me rezultate të shkëlqyera të mbështetur	Sipas viteve

Objektivi specifik O2.3 Deri në fund të vitit 2028, të forcohet bashkëpunimi shkollë–familje–komunitet përmes ngritjes dhe funksionalizimit të strukturave përfaqësuese dhe zhvillimit të aktiviteteve gjithëpërfshirëse, duke synuar përfshirjen rregullisht të të paktën 75% të prindërve në këshilla, organizimin e të paktën 3 fushatave vjetore në zonat me përfshirje të ulët dhe reflektimin e të paktën 15 propozimeve të komunitetit në planet institucionale.

Aktivitete	Periodha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues	Vlera e synuar:
Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për prindërit dhe kujdestarët, veçanërisht në lagje dhe fshatra me mungesë informacioni mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.	Tremujori I–II 2026, 2027, 2028	Drejtoria e Arsimit në Bashki	Drejtoria e Shëndetësisë, OJF lokale, Këshillat e Prindërve	Zëri 602 – Mallra dhe shërbime; Donatorë lokalë OSHC	Numri i fushatave të realizuara; Numri i prindërve të informuar	Viti 2026: 2 fushata në vit të organizuara në partneritet me drejtuesit e kopshteve dhe edukatorët; Viti 2027: 2 fushata në vit të organizuara në partneritet me drejtuesit e kopshteve dhe edukatorët; Viti 2028: 2 fushata në vit të organizuara në partneritet me drejtuesit e kopshteve dhe edukatorët;
Zhvillimi i bashkëpunimit me punonjësit socialë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës për të identifikuar fëmijët që nuk ndjekin kopshtin për shkak të kushteve ekonomike, kulturore ose sociale, dhe për të ofruar mbështetje të përshtatur, këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e	Tremujori II–III 2026, 2027, 2028	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, Drejtoria e Arsimit	Qendrat Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, OJF	Zëri 602 dhe 606 – Trajnime dhe koordinim; Projekte të mbështetura	Numri i fëmijëve të identifikuar Numri i fëmijëve të përfshirë në shërbim pas ndërhyrjes Raste të trajtuara përmes planit të mbështetjes	Identifikim, monitorim dhe raportim i rasteve sipas viteve

Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.						
Nxitja e përfshirjes së këshillave të prindërve dhe organizatave komunitare lokale në proceset vendimmarrëse, planifikuese dhe monitoruese të shërbimit arsimor, me qëllim rritjen e transparencës dhe bashkëpronësisë	Tremujori I–IV 2026, 2027, 2028 (proces i vazhdueshëm)	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bordi i Shkollës, Bordi i kopshtit, Këshillat e Prindërve, Komuniteti lokal	Zëri 600 dhe 606 – Orë pune, mbledhje dhe aktivitete komunitare	Përqindja (%) e prindërve që marrin pjesë rregullisht në takimet e këshillave të prindërve Numri i propozimeve të bëra nga prindërit/këshillat e prindërve që janë reflektuar në planet vjetore të institucionit	Viti 2026: Minimalisht 5 propozime të bëra nga prindërit/këshillat e prindërve që janë reflektuar në planet vjetore të institucionit; Viti 2027: Minimalisht 5 propozime të bëra nga prindërit/këshillat e prindërve që janë reflektuar në planet vjetore të institucionit; Viti 2028: Minimalisht 5 propozime të bëra nga prindërit/këshillat e prindërve që janë reflektuar në planet vjetore të institucionit;

Qëllimi 3 (Q3)– Të fuqizohet zhvillimi gjithëpërfshirës i fëmijëve përmes nxitjes së aftësive krijuese, sociale dhe sipërmarrëse, nëpërmjet programeve jashtëkurrikulare edukative, kulturore, sportive dhe teknologjike, në bashkëpunim me Qytezën e Fëmijëve dhe komunitetin

Objektivi specifik O3.1 Deri në fund të vitit 2028, të krijohet dhe të zbatohet një kalendar i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës me të paktën 12 aktivitete vjetore në institucionet e arsimit parauniversitar në Bashkinë Korçë						
Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues	Vlera e synuar:
Organizimi i programeve edukative, kulturore dhe sportive dhe të teknologjisë për fëmijët e arsimit parauniversitar në Bashkinë Korçë, nëpërmjet partneritetit me Qytezën e Fëmijëve. Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit: ¹ Bashkia mbështet aktivitetet jashtëshkollore të organizuara nga institucionet arsimore të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë për vitin shkollor, i cili miratohet për çdo vit.	Çdo vit	Qyteza e Fëmijëve Shkollat/kopshet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh;	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirës;	Jo më pak se 12 aktivitete vjetore, nga të cilat: Të paktën 4 aktivitete me fokus kulturor/artistik (p.sh. Dita e Alfabetit, Dita Botërore e Librit, ekspozita, koncertet për fëmijë, aktivitete me Qytezën e Fëmijëve) Të paktën 3 me fokus sportiv/lëvizor (p.sh. Java Olimpikë, gara me biçikleta, loja popullore në oborr, stafeta) Të paktën 3 me fokus teknologjik ose sipërmarrës (në bashkëpunim me Hub-in e Inovacionit – punëtori
1. 23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit  Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore)  Ushtrime në natyrë (gimnastikë)						

¹ Mbështetja me fonde të sigurohet edhe në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët nr. 11, datë 27.5.2024. Ky dokument përcakton rregullat dhe procedurat për menaxhimin e buxheteve të shkollave. Ai siguron që menaxhimi i fondeve buxhetore të jetë transparent dhe në përputhje me ligjet në fuqi, duke ndihmuar shkollat të menaxhojnë më mirë shpenzimet e tyre. Roli i Bashkisë është përcaktuar si aktor që vë fonde në dispozicion, si dhe lidhet edhe me proceset inventarizuese apo asistencë për zhvillim procedurash.

Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.)							<i>kreative, mini-projekte kodimi, lojëra logjike, mini-sipërmarrje)</i>
2. Prill–Maj – Java Olimpikë - Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa) - Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe - Gara me biçikleta							Të paktën 2 të dedikuara për përfshirjen e fëmijëve nga grupet në nevojë dhe zonat rurale
3. 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve - Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejtë të luaj) - Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët “Të drejtat e mia” "Unë mbroj të drejtat e mia" (bisedë)							<i>(p.sh. Dita e Romëve, Dita e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, aktivitete udhëzuese dhe ndërgjegjësuere në fshatra)</i>
4. Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor) Bisedë me fëmijët							
1. Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe - Postera me gjuhën shqipe & ilustrime - Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)							
2. Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor) - Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta - Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta) - Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK							
3. Dita Botërore e Gjuhës Amtare Vizitë në bibliotekë							

4. Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars) ✚ Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime) ✚ “Uji është jetë” (Postera, eksperiment me ujëra) ✚ Bisedë për vlerat e ujit						
5. Dita Ndërkombëtare e Romëve ✚ Bisedë për fëmijët romë						
6. Zakonet dhe traditat e romëve						
7. Dita Botërore e Librit (23 prill) ✚ Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues) ✚ Vizitë në bibliotekë ✚ Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)						
8. Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor) ✚ Ekspozitë me mjete të riciklueshme ✚ Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt) ✚ Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik) ✚ Mbajmë pastër mjedisin ku mësojmë e luajmë (aktivitet praktik, bisedë) ✚ Ekskursion në lulishten e qytetit						
9. Yjet e Vallzimit ✚ Konkurs midis kopshteve të qytetit						

Objektivi specifik O3.1 Të zgjerohet bashkëpunimi me institucionet kulturore, sportive dhe artistike në Bashkinë Korçë për të organizuar çdo vit të paktën 5 aktivitete masive edukative gjithëpërfshirëse, që angazhojnë të paktën 600 fëmijë (vajza dhe djem) në veprimtari që nxisin leximin, lëvizjen fizike, kreativitetin dhe ndjenjën e përkatësisë.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues	Vlera e synuar:
Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit:	Çdo vit	Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Prindër, OJQ	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse	5 aktivitete masive, me përfshirjen e min. 600 fëmijëve (vajza/djem)
1. Vizita në bibliotekë (për Ditën e Gjuhës Amtare dhe Ditën e Librit)	Shkurt & Prill	Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Biblioteka, Bashkia, Drejtoria Rajonale e Kulturës	Buxhet shkollor, mbështetje nga institucionet kulturore	Numri i vizitave në bibliotekë; pjesëmarrja e fëmijëve	12 vizita; min. 320 fëmijë pjesëmarrës
2. Fushata “Dhuro një libër, hap një dritare” (me bashkëpunimin e institucioneve kulturore)	Prill	Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Qendra Kulturore, Biblioteka, Prindër	Mbështetje donatorësh, Buxhet vendor	Numri i librave të dhuruar; numri i fëmijëve të përfshirë	100 libra të dhuruar; 150 fëmijë të përfshirë
3. “Pedalo për turizëm dhe kulturë” – aktivitet në hapësira publike me mbështetjen e institucioneve vendore  Pedalim me biçikleta në pedonalen e qytetit  Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera	Maj–Qershor	Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bashkia, Drejtoria e Kulturës, Policia Bashkiake	Bashkia, partnerë lokalë	Numri i fëmijëve pjesëmarrës; numri i punimeve ekspozuar	300 fëmijë; 50 punime
4. “Pedalo Kuq” – marshim festiv me bashkëpunim ndërsektorial për Festat Kombëtare	Nëntor	Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bashkia, Drejtoria e Arsimit, Policia Bashkiake, MAS	Buxhet vendor, sponsorizime private	Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku	Min. 500 pjesëmarrës; 80% e prindërve të kënaqur (sipas anketave)

10. Plani i investimeve kapitale

Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë lekë)

Nr.	Emërtimi i Projektit	Viti 2026 (000 lekë)	Viti 2027 (000 lekë)	Viti 2028 (000 lekë)	Shuma (000 lekë)
1	Rikonstrukcion i shkollave të arsimit bazë dhe arsimit parashkollor	24,600.00	23,000.00	23,000.00	70,600.00
2	Investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit bazë dhe arsimit parashkollor	15,400.00	17,000.00	17,000.00	49,400.00
3	Rikonstrukcion i shkollave të arsimit të mesëm parauniversitar	5,000.00	5,680.00	5,680.00	16,360.00
4	Investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit parauniversitar	931.00	1,000.00	1,000.00	2,931.00
Shuma		45,931.00	46,680.00	46,680.00	139,291.00

11. Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetsesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë si p.sh:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënës;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Përqindja e realizimit të objektivit $t = (\text{Pike të realizuara} / \text{Piket maksimale}) \times 100$

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Përqindja e pjesëmarrjes $= (\text{Numri real i pjesëmarrësve} / \text{Numri target}) \times 100$

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

12. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Korçë. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Korçë.

13. Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

14. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 69/2012**, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 48/2018**
- **Ligji Nr. 139/2015**, “Për Vetëqeverisjen 0Vendore”
- **Ligji Nr. 9936/2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/2017**, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025**
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

